

VENDIM
Nr.158, datë 13.2.2008

PËR IMPORT-EKSPORTIN E BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 82 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 7 të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Burimet radioaktive, që do t'i nënshtrohen procedurave të import-eksportit, si dhe pajisjet dhe sistemet, ku ato inkorporohen, janë përcaktuar në listën e miratuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Veprimet në pikat doganore për import-eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues kryhen vetëm pasi personat, fizikë apo juridikë, të kenë paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Licencë për veprimtari import-eksporti me burime të rrezatimit jonizues, lëshuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.

b) Leje për import-eksportin e burimeve jonizuese, përkatësisht:

- për burimet e kategorive 1 e 2, lëshuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.

- për burimet e kategorive 3, 4 e 5 dhe të gjeneratorëve me rrezatim x, të lëshuar nga zyra për mbrojtjen nga rrezatimet;

c) certifikatën e cilësisë së gjeneratorëve me rreze x, lëshuar brenda dy viteve të fundit, nga çasti i importimit.

3. Vendimi nr.56, datë 24.2.2000 i Këshillit të Ministrave shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha